

VENDIM
Nr.43, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA SHOQËRIA KORPORATA
ENERGJETIKE SHQIPTARE SHA TEK SHOQËRIA OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duke qenë se “Rregullorja për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, nuk zbatohet në këtë rast (sipas nenit 4 pika 3), Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.969, datë 2.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.”, dhe ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, si dhe çdo transferim tjetër të kryer nga Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aseteve nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., miratimi i të cilave është bërë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.969, datë 2.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në administrim të OSSH sh.a.” dhe ligjit nr.10116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, si dhe çdo transferim tjetër të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme nga shoqëria Korporata Energjetike Shqiptare sh.a. te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., nga momenti i kryerjes së çdo transferimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta